

**VENDIM**  
**Nr. 368, datë 26.4.2017**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 488, DATË 22.7.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT FAVORIZUES TË SHITJES SË PARCELËS NDËRTIMORE PËR NDËRTIMET PA LEJE, ME FUNKSION BANIMI DHE TË PËRZIER, TË SUBJEKTEVE QË PËRFITOJNË FALJE TË PAGESËS, SI DHE TË MËNYRËS E AFATEVE TË PAGESËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 488, datë 22.7.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në kreun III bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 11 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“11. Pas zbatimit të rregullave, sipas këtij kreu, mbi vlerën e mbetur të parcelës ndërtimore aplikohet një zbritje 10 për qind, për të nxitur poseduesit të zbatojnë detyrimet kontraktore të furnizimit me energji elektrike.”.

b) Pas pikës 11/1 shtohen pikat 11/2 dhe 11/3, me këtë përmbajtje:

“11/2. Në përputhje me nenin 17, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar, rregullat e parashikuara në kreun III, të këtij vendimi, aplikohen mbi vlerën e plotë të detyrimit financiar për parcelën ndërtimore. Me “vlerë të plotë” kuptohet vlera që i përket sipërfaqes së përgjithshme të parcelës ndërtimore, pas zbatimit të rregullave të përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të nenit të sipërpërmendur.

11/3. Rregullat e parashikuara në kreun III, të këtij vendimi, zbatohen edhe për objektet e tjera, sipas nenit 25, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar.”.

2. Për subjektet, të cilat përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi e kanë përfituar zbritjen si garanci për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike, kjo garanci falet. Në zbatim të kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t njoftojnë zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për të hequr kufizimin mbi pasurinë e legalizuar.

3. Pikat 22 dhe 23, të kreut IV, të vendimit nr. 1095, datë 28.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**  
**Niko Peleshi**